



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE -SUVA REKA



RREGULLORE PËR
MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Suharekë
Gusht 2019

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (i) dhe pika (k), lidhur me nenin 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (l), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e konform nenit 28, lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2019, miratoi këtë

RREGULLORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore i përcakton procedurat dhe masat për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në sistemin e qeverisjes komunale dhe kontribon në krijimin e komunës miqe për fëmijë.
2. Kjo rregullore është kontribut për të siguruar se Komuna e Suharekës hap pas hapi po ndërton një shoqëri të barabartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim që fëmija të jetë efektivisht i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Te gjitha institucionet shërbimet dhe qendrat për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, te cilat janë në administrimin e Komunës së Suharekës apo që veprojnë në nivel komunal, veprojnë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët, pa asnjë dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjine kombëtare ose shoqërore, pasurie, prejardhja familjare apo çdo lloj gjendjeje tjetër e fëmijës, prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë, ashtu si që është përcaktuar me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Neni 3 Përkufizimi i fëmijës

1. **Fëmijë**- nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
2. **I mitur**- nënkupton fëmijën mes moshës katërmëdhjetë (14) dhe tetëmbëdhjetë (18) vjet;
3. **Prind**- nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese;
4. **Kujdestari**- nënkupton personin që ka të njëjtat përgjegjësi për t'u kujdesur për fëmijën, si një prind dhe i cili disponon me kujdestarinë e plotë ligjore dhe fizike të fëmijës;

5. **Përfaqësues ligjor**- nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësiqe që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;
6. **Fëmijët** janë të mbrojtuar dhe i gëzojnë të gjitha të drejtat e njeriut siç parashihen në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatave të Kombeve të Bashkuar me 20 nëntor 1989 dhe në instrumentet dhe standardet tjera të zbatueshme që sigurojnë mbrojtjen dhe realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve.
7. **Fëmijët** janë një kategori e veçantë e personave të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik, intelektual dhe papjekurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve.
8. Për të siguruar mbrojtjen dhe kujdesin e nevojshëm për fëmijët, prindërit, familjet, përfaqësuesi ligjor dhe institucionet qeveritare mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e të drejtave të fëmijëve për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë, përfshirë mbrojtjen e duhur ligjore para dhe pas lindjes së tyre.

Neni 4

Parimet e përgjithshme të të drejtave të fëmijës

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm Konventa) i obligon shtetet që t'i sigurojnë të drejtat e fëmijës në mënyrë të plotë siç janë përcaktuar në konventë.
2. Në përputhje me Neni 22: Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, Kushtetuta e Republikës së Kosovës zbaton drejtpërdrejtë dhe kanë prioritet të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe "Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut" dhe "Konventa për të Drejtat e Fëmijës".
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, janë të bazuara në parimet e Konventës, të cilat janë:

- 3.1 **Mosdiskriminimi**-që nënkupton se të gjithë fëmijët brenda juridiksionit lokal i gëzojnë të drejtat e barabarta pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, përkatësisë etnike, origjinës kombëtare apo sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve apo kujdestarit ligjor.
- 3.2 **Interesat më të mira të fëmijës**-që nënkupton se në rast të ndonjë vendimi nga ana e institucioneve së pari do të merret parasysh interesi më i mirë i fëmijës i cili është subjekt i vendimit.
- 3.3 **E drejta e jetesës, mbijetesës dhe zhvillimit**-që nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social dhe kulturor.
- 3.4 **Pikëpamjet e fëmijës**- që nënkupton lirinë e fëmijëve për t'i shprehur pikëpamjet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta, si dhe obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar këto pikëpamje dhe për t'i marrë parasysh ato kur të marrin vendime që ndikojnë tek këta fëmijë, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit dhe pjekurisë të fëmijës.

Neni 5

Komuna mike për fëmijë

1. Komuna mike për fëmijë, është një sistem i qeverisjes së mirë lokale, e angazhuar për zbatimin e plotë të Konventës dhe realizimin e plotë të të drejtave të fëmijëve.
2. Komuna mike për fëmijë i garanton secilit fëmijë se do të:
 - 2.1 ndikojë apo marrë pjesë në vendimet e Komunës së vet;
 - 2.2 shprehë pikëpamjet e veta për Komunën;
 - 2.3 marrë pjesë në jetën familjare, të komunitetit dhe jetën sociale;
 - 2.4 marrë shërbimet kryesore si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternativ;
 - 2.5 pijë ujë të pastër dhe të ketë qasje në higjienën e duhur;
 - 2.6 jetë të mbrojtur nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër cënues për shkak të moshës apo papjekurisë;
 - 2.7 ndjehet i sigurtë në rrugët e qytetit dhe në mjedisin ku jetonë;
 - 2.8 takohet dhe luajë me shokët;
 - 2.9 jetojë në një mjedis të pastër dhe të shëndetëshëm;
 - 2.10 marrë pjesë në ngjarjet kulturore, sportive dhe shoqërore;
 - 2.11 një qytetar i barabartë i Komunës, me qasje në secilin shërbim, pavarësisht nga përkatësia etnike, feja, të ardhurat, gjinia apo aftësia dhe mendimit të ti politik.

Neni 6

Përgjegjësitë për të drejtat e fëmijës

1. Realizimi i të drejtave të fëmijës është përgjegjësi kryesore e familjes dhe llogaridhënie morale dhe e vetë-imponuar e institucioneve shtetërore.
2. Çdo zyrtar publik, secili institucion komunal, çdo institucion i nivelit qendror që vepron në nivel komunal dhe çdo subjekt tjetër që lidhet me fëmijët të gjithë kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës, në përputhje me konceptin e Komunës mike për fëmijë.
3. Palët përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në Komunë mike për fëmijë përfshin por nuk kufizohen në këto palë:
 - 3.1 zyra e Kryetarit të Komunës, Kuvendi komunal dhe drejtoritë e Komunës;
 - 3.2 organet e drejtësisë për fëmijë (policia, gjykata, prokuroria, shërbimi provues i Kosovës, shërbimi korrektues i Kosovës, etj);
 - 3.3 mekanizmat koordinuese për mbrojtjen e fëmijëve në nivel të Komunës;
 - 3.4 zyrtari/ja për të drejtat e njeriut/fëmijës në Komunë;
 - 3.5 qendra për punë sociale;
 - 3.6 institucionet shëndetësore;
 - 3.7 shkollat, përfshirë të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit para universitar;
 - 3.8 klubet dhe shoqatat sportive dhe artistike;
 - 3.9 institucioni i avokatit të popullit;
 - 3.10 bashkësitë lokale;
 - 3.11 shoqatat dhe këshillat e prindërve;
 - 3.12 organizatat e shoqërisë civile;
 - 3.13 zyrat dhe njësitë e organizatave ndërkombëtare në Komunë;
 - 3.14 shoqatat profesionale;
 - 3.15 organet tjera formale dhe joformale që si qëllim parësor kanë promovimin e

- mbrojtjes së përgjithshme sociale dhe mirëqenies të të gjithë fëmijëve;
3.16 këshilli komunal për siguri në bashkësi;

Neni 7

Bashkëpunimi ndërkomunal, ndërinstitucional dhe me organizatat joqeveritare

1. Komuna bashkëpunon me komunat e tjera për të gjitha çështjet që nderlidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ne përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Komuna bashkëpunon me institucionet e drejtësisë, policinë, prokurorinë, gjykatat shërbimin sprovues dhe shërbimin korrektues, si dhe me organizatat joqeveritare.

Neni 8

Mekanizmat koordinuese për të drejtat e fëmijës

1. Mekanizmi koordinues i Komunës shërben si një platformë apo rrugë për vendosjen e prioritetëve dhe sistemeve të sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, veçanërisht për vënien në praktikë të angazhimeve dhe veprimeve të politikave ekzistuese.
2. Mekanizmi koordinues i Komunës krijon një mjedis mundësues për përgatitjen e planeve të veta për zhvillim, planifikon buxhetet dhe monitoron zbatimin e programeve të tyre përkatëse.
3. Kryetari i Komunës emëron kryesuesin e mekanizmit koordinues dhe është përgjegjës për angazhimet e Kuvendit të Komunës për politikën dhe shërbimet për fëmijë.
4. Komuna, me një vendim të veçantë, përcakton mekanizmat koordinues për realizimin e të drejtave të fëmijës në sistemin e qeverisjes komunale (njësia komunale për të drejtat e njëriut në komunë, zyrtari/ja për të drejtat e fëmijëve) përfshirë kushtet e punës të përkufizuara për rolet, përgjegjësitë dhe rregullat e procedurës.
5. Ky mekanizëm është i përbërë nga palë dhe institucione të ndryshme dhe në të përfaqësohen edhe njësi të ndryshme si dhe grupe të tjera formale dhe joformale.
6. Përbërja e këtij mekanizmi përcaktohet nga akti i themelimit të mekanizmit me kushtet e punës të përkufizuara.
7. Mekanizmi koordinues do të ketë këto detyra:
 - 7.1 promovojë konceptin e Komunës dhe praktikën e përkufizuara sipas mjeteve dhe udhëzimeve të krijuara;
 - 7.2 sigurojë koordinimin e politikave të cilat ndikojnë tek fëmijët;
 - 7.3 sigurojë që të gjitha aspektet e kornizës ligjore të cilat janë nën kontrollin e Komunës i promovojnë dhe i mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Ndërkohë, të veprojnë si një mbështetës i fuqishëm i fëmijëve duke ndikuar në legjislacionin mbi të cilin nuk ka kontroll (ai në nivel vendi) të bëjë të njëjtën gjë;
 - 7.4 kryejë vetëvlerësime periodike të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga Komuna në mënyrë që të krijohet një komunë miqe për fëmijë;
 - 7.5 udhëheqë procesin e hartimit të një strategjie komunale dhe një plani të veprimit tre (3) vjeçar dhe të vëzhgojë zbatimin e tij bazuar në vetëvlerësimin komunal;
 - 7.6 sigurojë një sistem komunikimi që mundëson rrjedhën e informacionit ndërmjet pikëpamjeve të fëmijëve që konfirmon se janë duke u respektuar në punën e tij dhe në punën e mbarë qeverisjes në nivel komunal;

- 7.7 sigurojë sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve komunale dhe njërive specifike të institucioneve relevante, përgjegjëse për çështjet e fëmijëve;
- 7.8 bëjë rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
8. Mekanizmi duhet të zhvilloj disa tregues që do të masin gjendjen aktuale të të drejtave të fëmijëve në Komunë.
9. Mekanizmi nuk e përjashton krijimin e organeve, ekipeve dhe mekanizmave të tjerë, në vartësi të këtij mekanizmi, qofshin ato të përkohshme apo të përhershme, të orientuara në aspekte të veçanta të të drejtave të fëmijëve.
10. Megjithatë, kjo e fundit duhet t'i mbajë marrëdhëniet me mekanizmat, të raportojë mbi punën e tyre dhe të marrë këshilla dhe rekomandime nga mekanizmat koordinues.
11. Mekanizmit i jepet autoriteti më i lartë i Komunës, se i përgjigjet drejtpërdrejt kryetarit të Komunës.

Neni 9

Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët

1. Komuna zhvillon një proces për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjislacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë.
2. Ky proces vlerëson situatën e të gjithë fëmijëve, me vëmendje të veçantë tek fëmijët nga grupet e pa favorizuara.
3. Sigurohet që vlerësimi i ndikimit tek fëmijët fillon mjaft herët, gjatë analizës së situatës dhe formulimit të ndërhyrjeve tek fëmijët për të pasur ndikim në vendim-marrje bazuar në interesin më të mirë të fëmijës.
4. Komuna kryen një vlerësim të rregullt të ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët.
5. Sigurohet një hapësirë për procesin e pavarur të vlerësimit në lidhje me ndikimin e politikave në praktikat dhe shërbimet për fëmijë.

Neni 10

Sistemi i raportimit të rregullt mbi gjendjen e fëmijëve

1. Mekanizmi koordinues komunal, i përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritetet të Komunës për fëmijët dhe interesat e tyre.
2. Ky mekanizëm obligon Komunën të raportojë në mënyrë periodike mbi gjendjen aktuale dhe të asistojë në monitorimin dhe vlerësimin e progresit për një Komunë mike për fëmijë.
3. Komuna i përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve komunale në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin nga sektorët përkatëse, të lidhura me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
4. Në rast kur Komuna nuk ka të dhëna të mjaftueshme, ata janë të obliguar t'i sigurojnë ato në bashkëpunim me nivelin qendror.
5. Komuna e cakton njësinë përgjegjëse apo zyrtarin përgjegjës në Komunë për të nxjerrë të dhëna të rëndësishme dhe raportim të rregullt mbi statusin e treguesve, të cilët sigurohen nga institucionet përgjegjëse komunale dhe u raportohet zyrtarisht në baza vjetore.
6. Komuna i shfrytëzon në mënyrë efektive raportet për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetim për fëmijë dhe duke u bazuar në nevoja kërkon nga njësitë përgjegjëse t'i azhurojnë të dhënat dhe raportimet në çdo kohë.

Neni 11

Buxheti për fëmijë

1. Komuna zhvillon një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e Komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit.
2. Ky proces përfshinë:
 - 2.1 identifikimin nëse fëmijët janë duke i pranuar pjesët e duhura të burimeve për investime publike, në shërbime ku shpërndarja administrohet nga niveli i vendit;
 - 2.2 identifikimi i nevojave për shërbime sociale për fëmijet dhe mbështetja e planifikuar përmes buxhetit komunal;
 - 2.3 analizën adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen dëshmitë e gjeneruara për të investuar në fëmijë;
 - 2.4 Komuna zhvillon një proces për planifikim të buxhetit komunal i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët e interesit, duke i përfshirë edhe fëmijët.
 - 2.5 Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.

Neni 12

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

1. Komuna ndërmerr masa të qarta në mënyrë që të promovohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, si nga fëmijët ashtu edhe nga të rriturit.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - 2.1 organizmin e trajnimeve për të drejtat e fëmijëve për udhëheqësit komunal dhe zyrtarët kryesorë komunal;
 - 2.2 përfshirjen e mësimit rreth të drejtave të fëmijëve dhe Konventës në të gjitha nivelet e kurrikulave të shkollës dhe zbatimin e saj në mësim dhe në praktikë;
 - 2.3 përfshirjen e mësimit dhe promovimit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në kuadër të programeve të trajnimit para dhe gjatë shërbimit për persona të cilët punojnë me ose për fëmijë në nivel komunal;
 - 2.4 Vlerësimin e rregullt të njohurive për të drejtat e fëmijëve në mesin e të rriturve dhe fëmijëve.
 - 2.5 Promovimin e punës së institucioneve të cilat e kanë për mandat ligjor promovimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
3. Komuna krijon partneritete me institucionet qendrore dhe gjithashtu me organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve në territorin e Komunës së Suharekës.

Neni 13

Avokimi i pavarur për fëmijë

1. Komuna krijon një sistem të qëndrueshëm të partneritetit me një spektër të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të pavarura të cilat avokojnë për të drejtat e fëmijëve.
2. Në këtë drejtim duhet të angazhohen:

- 1.1 organizatave joqeveritare (OJQ) u jepet mbështetje adekuatë për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrje në mënyrë të pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve;
 - 1.2 inkurajohen dhe mbështeten organizatat e të rinjve dhe fëmijëve;
 - 1.3 lehtësohet themelimi i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve;
 - 1.4 mbahen komunikime të rregullta me OJQ-të dhe institucionet e pavarura, në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në Komunë, nga një perspektivë tjetër.
3. Kuvendi Komunës organizon të paktën një seancë vjetore për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijës duke iu referuar raportit të situatës për fëmijë (Neni 9, pika 4 e kësaj rregulloreje).
 4. Komuna organizon “ditët mike për fëmijë” dhe diskuton çështjet lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Neni 14 **Pjesëmarrja e fëmijës**

1. Komuna siguron pjesëmarrje aktive të fëmijëve në rastet që janë me interes për ta, në çdo proces vendim-marrës në nivel të komunës.
2. Të gjithë zyrtarët publikë, institucionet dhe njësitë komunale institucionale, janë të obliguara që ta pasqyrojnë këtë në punën e tyre.
3. Institucionet edukative-arsimore e mundësojnë mësimin dhe praktikimin e pjesëmarrjes aktive përmes kurrikulës së shkollës dhe aktiviteteve ekstra-kurrikulare dhe në koordinim me institucionet e sektorëve përkatës të cilët janë drejtpërdrejt në kontakt me fëmijët gjatë ofrimit të shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe të mirëqenies sociale.
4. Institucionet edukative, sportive dhe kulturore e nxisin krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve sportive, artistike dhe kulturore, etj.
5. Organet administrative dhe gjyqësore në Komunë në rastin e vendim-marrjes për rastet që ndikojnë tek fëmijët, i marrin plotësisht parasysh pikëpamjet e fëmijëve, dhe në përputhje me praktikën dhe udhëzimet e përcaktuara nga legjislacioni ekzistues.
6. Pjesëmarrja kuptim plotë e fëmijëve sigurohet në procesin e vlerësimit të ndikimit të ligjeve, politikave dhe praktikave tek fëmijët, në procesin e raportimit për gjendjen e fëmijëve në Komunë, në procesin e buxhetimit për fëmijë si dhe në promovimin e të drejtave të fëmijëve për fëmijë dhe të rritur.
7. Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e fëmijëve, Komuna e merr parasysh dhe bashkëvepron rregullisht me organizatat rinore si organ primar që i përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve karshi moshës dhe pjekurisë së tyre.

Neni 15 **Pjesëmarrja e fëmijëve përmes Asamblesë komunale të fëmijëve**

1. Asambleja komunale për fëmijët themelohet me Vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.
2. Asambleja komunale e fëmijëve, krijohet me qëllimin që, në mënyrë të drejtpërdrejtë, t'i përfaqësojë fëmijët, opinionet dhe pozitën e fëmijëve në komunë dhe në shoqëri.
3. Të drejtat dhe obligimet e Asamblesë komunale të fëmijëve përcaktohen me vendimin, të cilin e nxjerr Komuna me rastin e themelimit të Asamblesë komunale për fëmijët.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Procedurat për zbatimin e Rregullores

1. Mekanizmi i koordinimit ose ndonjë organ tjetër komunal ose i pavarur e monitoron zbatimin e kësaj rregullore dhe nxjerr raporte vjetore.
2. Kuvendi i Komunës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të mekanizimit koordinues për nivelin e zbatimit të rregullores.
3. Në rast të mospërmblidhjes së detyrave lidhur me zbatimin e Rregullores nga zyrtar publik, organet përkatëse komunale marrin masa adekuate në pajtim me procedurat komunale.
4. Kryetari i komunës brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, nxjerrë vendimet e parapara sipas nenit 8 pika 3, neni 10 pika 5 dhe nenit 15, për zbatimin e saj.

Neni 17

Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj rregullore dhe në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 18

Ndryshim Plotësim

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, kjo rregullore hynë në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-62009
Me data 30.08.2019


Kryesuesi i Kuvendit
Bexhet KUÇI